



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/182
Datë: 11.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkriptet nga mbledhjet 173, 174, 175 dhe 176 të Qeverisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Hashim THAÇI
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:
- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/182

Datë: 11.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2014, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe Plotësimin e vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/176 të datës 10 mars 2014

1. Ndryshohet pika 1. e Vendimit të Qeverisë nr. 01/176 i datës 10 mars 2014 e plotësuar dhe ndryshuar me vendimin 03/177 të datës 14 mars 2014 si në vijim:

Pas fjalës “Shërbimin i Jashtëm i Republikës së Kosovës” shtohet teksti si në vijim: “Nga rritja e pagave përjashtohen edhe udhëheqësit e të gjitha agjencive dhe institucioneve të pavarura të cilat i raportojnë Kuvendit të Republikës së Kosovës, anëtarët e bordeve të Agjencive të Pavarura, si dhe të emëruarit tjerë në agjenci dhe institucione të pavarura të cilët janë të emëruar/zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës”.

2. Pika 2.2. e vendimit të Qeverisë 01/176 e datës 10. 03. 2014, plotësohet dhe ndryshohet si në vijim: “2.2. Kategoritë në vazhdim në nivelin 25 %:

- 2.2.1. Familjet e dëshmorëve të UÇK-së;
- 2.2.2. Familjet e viktimave civile të luftës së UÇK-së;
- 2.2.3. Invalidët civilë të luftës së UÇK-së;
- 2.2.4. Familjet e personave të zhdukur;

3. Obligohet Ministria e Administratës Publike, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/182

Datë: 11.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 dhe 8 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejme i kërkesës për shpronësim, për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Qendrës Turistike Brezovica, Zona Kadastrale Berofc, Vërbeshtica, Jazhince, Gotovusha dhe Shtërpcë të Komunës së Shtërpcës, sipas tabelave të bashkangjitur këtij vendimi.
2. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205 dhe Udhëzimin Administrativ nr. 13/2011 Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të Vlerësimit që do të përdorën për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit/MMPH, Ministria e Financave dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.
4. Mjetet financiare për kompensimin e shpronësimit do t'i siguroj Qeveria e Republikës së Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/182

Datë: 11.04.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 prill 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet projekti i dorëzuar nga Këshilli Britanez, në bashkëpunim me Ministrinë e Jashtme të Kosovës dhe Ministrisë së Jashtme të Mbretërisë së Bashkuar, për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 500,000.00 (pesëqind mijë) euro për sigurimin e këshillave ligjore dhe shërbimeve të ndërlidhura të diplomacisë publike, për përgatitjen e dokumentacionit dhe procedurave tjera përcjellëse për aplikim për anëtarësim në Këshillin e Evropës, Komisionin e Venedikut dhe mbarëvajtjen e procesit të negociatave për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga shpenzimet e paparashikuara të Qeverisë, kategoria ekonomike rezervat, dhe barten në organizatën britaneze British Council, dega në Kosovë.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi dhe ministritë e linjës për zbatimin e projektit nga pika 1. e këtij vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI


Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë